



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Politika për sigurimin e cilësisë në Kolegjin BIZNESI është hartuar në mbështetje të Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, në Statutin e Kolegjit neni 81; në Rregullore e brendshme e Kolegjit BIZNESI, kreu 6 dhe neni 79.80. dhe 81.; si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe që është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor datë 25.09.2020, të Kolegjit BIZNESI.

### **POLITIKA PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË KOLEGJIN BIZNESI**

Qëllimi i politikës për sigurimin e cilësisë është të përshkruaj sistemin e sigurimit institucional të cilësisë, proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimin, grumbullimin e të dhënave, afatet kohore, ciklin e cilësisë, përgjegjësitë e të gjithë individëve dhe njërive që janë të përfshira në këto procese në Kolegjin Biznesi. Politika për Sigurimin e Politika është dokument publik i publikuar dhe i shpallur në web faqen e institucionit (<http://kolegjibiznesi.com/frmArtikujt.aspx?ID=5276>).

Vendosja e një kulture të cilësisë në funksionimin e Kolegjit Biznesi paraqet detyrë të rëndësishme të Kolegjit. Sigurimi i cilësisë në të tre fushat e misionit të Kolegjit (arsimore, shkencore dhe shërbimeve publike) është një përgjegjësi e Kolegjit dhe kujdesi për cilësinë duhet të zbatohet në çdo vend pune dhe në të gjitha fushat e veprimtarisë. Sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të vendoset duke u bazuar në dokumentet përkatëse (rregullore dhe manuale), me zbatimin e standardeve si Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë - SUE (Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area – ESG) dhe kur ekzistojnë praktika të mira, të tillat të zbatohen. Për realizimin e veprimtarisë së qëndrueshme për sigurimin e cilësisë duhet të krijohet një strukturë e përshtatshme organizative. Funkcionet e sigurimit të cilësisë në të gjithë institucionin janë integruar plotësisht në strategjitë normale të zhvillimit dhe planifikimit në një cikël të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe rishikimit (Cikli PDCA – Plan, Do, Check dhe Act). Sistemi i sigurimit të cilësisë mbulon të gjithë gamën e aktiviteteve institucionale.

Megjithatë, duhet theksuar që gjitha njësitë akademike dhe administrative brenda institucionit (duke përfshirë edhe organin drejtues dhe menaxhmentin e lartë), çdo i punësuar në Kolegj dhe secili student ka përgjegjësi për cilësinë në kontekstin e përgjegjësive profesionale ose studentore të tij. Kolegji Biznesi si prioritet themelor të sistemit për sigurimin e cilësisë përcakton ruajtjen e vlerave akademike të institucionit dhe arritjen e standardeve akademike dhe në përputhje me këtë ndërton një sistem të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë, duke siguruar burime adekuate

njerëzore, financiare dhe materiale për udhëheqjen dhe menaxhimin e proceseve të sigurimit të cilësisë..

Parimet themelore mbi bazën e të cilëve do të krijohet sistemi për sigurimin e cilësisë janë:

1. Vendosja e metodave dhe standardeve të punës që do të çojnë në përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë arsimore-shkencore dhe përmirësimin e aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përputhje me qëllimet strategjike të Kolegjit Biznesi.
2. Aktivitetet e sistemit të sigurimit të cilësisë të realizohen në përputhje me dokumentet strategjike të Kolegjit, me dispozitat ligjore në Republikën e Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE) dhe kriteret e vlerësimit të jashtëm të Agjencisë Kosovare për Akreditim (AKA).
3. Të zhvillohen procese për realizimin e veprimtarisë akademike dhe administrative dhe zbatimi i tyre në mënyrë transparente,
4. Të vendoset sistem për monitorimin e treguesve të përmirësimit të cilësisë që do të përdoren në proceset e vendimmarrjes dhe planifikimit strategjik,
5. Sistemi të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë palët e interesit: studentët, punëdhënësit, komunitetin lokal dhe shoqërinë, ministrinë përkatëse dhe agjencitë kombëtare,

Sistemi për sigurimin e cilësisë i përket funksioneve të zakonshme të Kolegjit dhe është pjesë e jetës së përditshme të punës së tij. Përgjegjësia për sistemin e sigurimit të cilësisë i takon Dekanit dhe Këshillit të Lartë Mësimor-Shkencor (KLMSH) të cilët, me ndihmën e Komitetit për menaxhimin e cilësisë dhe Zyrës për Menaxhimin e Cilësisë do të mbikëqyrin krijimin dhe implementimin e një sistemi për menaxhimin e cilësisë. Me Rregulloren për punën e Zyrës për cilësi dhe Rregulloren për punën e Komitetit për menaxhimin e cilësisë përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë e zyrës dhe komitetit të menaxhimit të cilësisë dhe marrëdhëniet e tyre me njësitë e tjera administrative dhe të planifikimit.

KLMSH emëron Komisionin për vetëvlerësim i cili ka për përgjegjësi të realizoj vetëvlerësime të rregullta në fund të çdo semestri dhe të raportoj, duke ofruar pasqyrë mbi performancën e institucionit në tërësi dhe për degët brenda institucionit.

Kolegji Biznesi bazuar në Rregulloren për evaluim të brendshëm (Vetëvlerësim) dhe vlerësim të cilësisë për aktivitetet në të gjithë institucionin (veprimtari akademike, shërbime studentore, administrim etj.) përdorën format e përbashkëta dhe instrumentet e anketimit, ndërsa, rezultatet e anketimit (përgjigjet e marra, të dhëna statistikore) të grumbulluara nga studentët, stafi, të diplomuarit dhe punëdhënësit bëhen publike dhe sistemohen në një bazë të dhënash qendrore në të cilën kanë qasje departamentet dhe njësitë gjatë përgatitjes së raporteve mbi treguesit dhe detyrat e tjera në monitorimin e cilësisë dhe ndërmarrjes të planifikimit të aktiviteteve për përmirësim (korrigjuese) të bazuara në gabimet dhe dobësitë e njohura nga përgjegjësit.

Implementimi i sistemit për sigurimin e cilësisë në nivel institucional menaxhohet nga Dekani ndërsa për implementimin e sistemit për sigurimin e cilësisë në degë është përgjegjës ,Përgjegjësi i degës. Dekani dhe Komiteti janë përgjegjës për sistemin e sigurimit të cilësisë gjatë takimeve dhe mbledhjeve sigurimit të cilësisë.

Politika për sigurimin e cilësisë në Kolegjin Biznesi rishikohet rregullisht dhe, nëse është e nevojshme, nga KLMSH do të miratohet dokument i ri i përshtatur me kërkesat e reja.

Prishtinë, me \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

KLMSH i Kolegjit BIZNESI  
K r y e t a r i

---

/Prof dr Shyqeri Kabashi/